



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:154938

Datë: 03.01.2024

Numri i dokumentit: 05149526

P.nr.93/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. B. nga fshati Sh., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.67/2023 të datës 13.07.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 13.09.2023, në prezencën e prokurorit të shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarit B. B., **më 18 shtator 2023, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. B.** nga i ati A.dhe e ëma H., e gjinisë K., i lindur më ... në fshatin Sh., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, atë i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor në ndërtimtari, i dënuar më par, veteran, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më datë 15.02.2022, rreth orës 12:30/h, në fshatin Sh., Komuna e Malishevës, i pandehuri B. B., me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit- viktimës së ndjeshme/ fëmijës se moshës ... vjeçare L. B., në atë mënyrë që ditën kritike pasi dëmtuari ishte duke luajtur me disa fëmijë tjerë me mjete piroteknike në rrugën e fshatit, i pandehuri me t'i vërejtur afrohet tek ata dhe i u tërheq vërejtjen që mos ti përdorin, mirëpo i dëmtuari prapë vazhdon të luaj, atëherë i pandehuri i revoltuar e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me shuplakë në regjionin e fytyrës si dhe me shqelm, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe atë ndrydhje të indeve të buta në faqen e djathtë, të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore të Dr. B. C. datë 24.05.2023.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,40,42,46,47,48,49,69,70,185 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe nenit 241,242, dhe 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i pandehuri **B. BY.** dënohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhë prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, për shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore në shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 40,00 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari i mitur L. (I.) B. së bashku me përfaqësuesin ligjor babin I. B. nga fshati Sh., Komuna e Malishevës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur PP/II.nr.67/2023 të datës 13.07.2023, kundër të akuzuarit B. B. nga fshati Sh., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 13.09.2023, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj, njëherë bënë përmirësimin e mbiemrit të akuzuarit e tani e tutje duhet të jetë B. B., ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pasi që i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, kërkojë nga gjykata që të njëjtin ta dënoj sipas ligjit duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I akuzuari B. B., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të dëmtuarit i kërkoj falje, ky është rasti imë i parë që kam kryer vepër penale, i premtoj gjykatës se nuk do të përsërisë vepër tjetër penale, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj me kusht pasi që jam i gjendjes jo të mirë ekonomike.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: ekspertiza mjekoligjore e Dr. B. C., dt. 24.04.2023; fillestar i incidenti nr. ... dt.15.12.2022; Q.K.M.F M., raporti mjekësor për L. B., nr. rendor i protokollit ...i dt. 15.12.2022; procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin I. B. nr. ... dt.15.12.2022; procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarit/pandehurit B. B. nr. ... dt.15.12.2022; raporti i policit F.K., nr. dt.15.12.2022, si dhe shkresa tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinimin e pranimit të fajësisë fillestar nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtton Gjykatës se nuk do të përsërisë ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa Gjykata si rrethanë rënduese mori faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë dhe atë: I. Sipas lëndës P.nr.139/2014 i plotfuqishme më 28.06.2016, sipas nenit 320 të KPRK-së, i dënuar me kusht prej 3 muaj brenda 1 viti, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, dënohet me dënim me kusht në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhë prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364, 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.93/2023, më 18 shtator 2023

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën